

Shpresa GJONGECAJ

EMISIONE TË REJA MONETARE NGA QYTETI ANTIK I SKODRËS

Qëllimi i këtij artikulli është të paraqesë disa emisione të reja, të prera nga punishtja monetare e Skodrës, të cilat kanë qenë të panjohura më parë.

Përgjatë fushatave të gërmimeve arkeologjike të kryera në Shkodër, Lezhë por edhe nga gjetjet e rastit, është zbuluar një material i pasur numizmatik, që hedh dritë mbi qarkullimin monetar në qytetin antik të Skodrës, qendër e rëndësishme e mbretërisë ilire dhe për më tepër mbi aktivitetin monetar të vetë qytetit. Të dhënat numizmatike ashtu sikurse ato arkeologjike, dëshmojnë se Skodra pati një jetë të gjallë dhe intensive midis shekujve III-II p.e.s. dhe që një nga qendrat më të rëndësishme të shtetit ilir.¹

Në literaturën numizmatike monedhat e prera në atelienë e Skodrës kanë zënë vend krahas monedhave të Lissos dhe të mbretit Gent. Ato janë bërë të njohura qysh në vitin 1779, kur Eckhel, babai i numizmatikës botërore, boton në librin e tij *Doctrina Numorum Veterum* edhe dy monedha të prera në Skoder². Më pas A. Evans, në vitin 1880 pas udhëtimit të tij në Shqipëri mbledh një sasi monedhash nga Shkodra

¹ WILKES 1992, f. 156-170; ISLAMI, CEKA 1964, f. 1-9. CABANES 1988, f. 191-209.

² ECKHEL 1779, f. 152-160.

dhe territori dhe i depoziton në Ashmolean Museum, ku ruhen edhe sot. Midis tyre, një interes të veçantë paraqet një thesar i përbërë nga 38 copë bronz në një enë balte, i gjetur në fshatin Selc ku ndodheshin krahas monedhave të Lissos, mbretit Gent edhe ato të Skodrës. Këtë thesar A. Evans e boton në *Numismatic Chronicle*³. Nga Skodra ai boton tipin mburojë/përkrenare, të përfaqësuar me 12 copë. Në vitin 1898 J. Brunsmid bëri një botim më të plotë të monedhave të Skodrës dhe të Gentit përfshirë ato të botuara apo të pabotuara deri atëherë⁴. J. Scholz në vitin 1901 boton disa monedha të Skodrës të gjetura në fshatin Rrenc, shumë pranë Shkodrës⁵. Koleksionin e monedhave të Skodrës, Lissos dhe Gentit e pasurojnë Praschniker-Schober, të cilët në botimin e tyre na japin gjetje të reja.⁶

Kemi gjithashtu shumë *Sylloge* ku prezantohen edhe monedhat e Skodrës krahas atyre të qyteteve ilire dhe kryesisht, Dyrrahut dhe Apolonisë.

Një studim më i gjerë mbi monedhat e Skodrës, Lisit dhe Gentit bëhet nga S. Islami, ku ai përmbledh të gjitha monedhat e botuara apo që gjenden në koleksione të ndryshme. Duke qenë një historian i antikitetit, ai i ka trajtuar monedhat më shumë në aspektin historik duke i ndarë në periudha të caktuara kronologjike. Nuk ka tipe të reja përveç atyre të njohura më parë nga literatura numizmatike⁷. Sipas S. Islamit, Skodra pret monedha në tri periudha të rëndësishme historike:

Faza e Parë, 250-181 p.e.sonë

1. Koka e Zeusit dj./ Anije ilire, poshtë delfin, legjenda ΣΚΟ-ΔΡΑΙΝΩΝ, në dy rreshta vendosur mbi anije. (3.30-5 gr)
2. Mburojë/Përkrenare ilire në profil, Σ-ΚΟ-ΔΡΑΙ-ΝΩΝ (2.10-3.5 gr.)

Faza e dytë, 181-168 p.e.sonë (periudha e mbretërimit të Gentit).

1. Busti i mbretit me kausia dj./ Anije ilire, ΒΑΚΙΑΕΩΣ ΓΕΝΘΙΟΥ (3.30-5 gr.)
2. Mburojë/Përkrenare ilire në profil, ΒΑΚΙΑΕΩΣ ΓΕΝΘΙΟΥ (2.10-3.5 gr.)
3. Koka e Artemisë dj. - Rrufe, ΒΑΚΙ-ΓΕΝ (1.10- 2.16 gr.)

³ EVANS 1880, f. 269-288.

⁴ BRUNSMID 1898, f. 70-75.

⁵ SCHOLZ 1901, f. 123-126.

⁶ PRASCHNIKER, SCHOBER 1919, f. 22.

⁷ ISLAMI 1972, f. 379-408.

Faza e tretë, pas 168 p.e.sonë.

1. Koka e Zeusit dj./ Anije ilire, sipër saj ΣΚΟ-ΔΡΙΝΩΝ, poshtë emri i nëpunësit monetar (3.30-5 gr.)

Ndërsa Lissos pret monedha në një periudhë, gjatë viteve 250-181 p.e.sonë dhe pikërisht emisionet:

1. Dhi dj./ Rrufe, ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ (1.64 gr.)
2. Mburojë/Përkrenare ilire në profil, ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ (1.60-2.30 gr.)
3. Koka e Artemisë dj. - Rrufe, ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ (1.10-1.30 gr.)

Një koleksion i ri i shtohet pasurisë numizmatike të Skodrës, i cili vjen nga gërmimet e fundit të kryera në Lissos apo edhe nga gjetjet e rastit në zonën përreth Shkodrës. Bëhet fjalë për tri tipe të reja monetare:

Tipi I

Fq. Mburoja me një rreth koncentrik dhe gjashtë segmente në anët; midis segmenteve nga një pikë.

Shp. Bashi i anijes, sipër ΣΚΟΔΡΙΝΩΝ në dy rreshta.

Emisioni A

Me bashin e anijes të kthyer majtas, sipër ΣΚΟ-ΔΡΙΝΩΝ, në dy rreshta:



Nr.	Pesha (gr.)	Diam.(mm)	Nr.Inv.	Vendi i gjetjes
1	1.06	10	8020/1	Shkodër
2	1.38	11	9469	Lezhë 2011
3	1.96	12	9514	Lezhë 2011
4	0.86	10	9468	Lezhë 2010

Emisioni B

Me bashin e anijes të kthyer djathtas, sipër ΣΚΟΔΑ-PINΩΝ në dy rreshta:



Nr.	Pesha (gr.)	Diam. (mm)	Nr.Inv.	Vendi i gjetjes
1	0.50	8	3819/1	Shkodër ?
2	0.73	8	9470	Lezhë 2010
3	0.83	8	9467	Lezhë 2010
4	1.20	10	8020	Shkodër ?
5	1.21	11	8060	Lezhë 1983

Të dy emisionet janë prerë me një peshë të vogël që shkon nga 0,50 deri në 1,96 gr. dhe diametër 8-12 mm. Po të nisemi nga simbolet që kjo monedhë mban, do ta lidhnim pa asnjë dyshim me Scodren sepse simboli i faqes – mburoja – përbën simbolin e një tipi monedhe të prerë nga Shkodra, por edhe nga Lezha, pikërisht atë me mburojë/përkrenare. Mburoja dhe përkrenarja e përdorur mbi monedhat e Skodrës, Lisit dhe Gentit përfaqësojnë armët mbrojtëse ilire, të pajisura me zbukurime dhe forma autoktone ilire. Këto armë u përdorën gjerësisht nga ilirët në luftrat kundër maqedonasve dhe romakëve.

Në 1967, profesor H. Ceka boton librin *Probleme të Numizmatikës Ilire* me një katalog të monedhave të pabotuara apo të rralla të Ilirisë së Jugut, ku trajton monedhat e prera nga Skodra dhe Lissos dhe polemizon mbi autencitetin e simboleve të përdorura mbi këto monedha, kryesisht mbi përkrenaren dhe mburojën⁸. Sipas tij mburoja, një armë mbrojtëse, ishte në përdorim tek të dy popujt, maqedonas dhe ilirë, ndërsa përkrenarja ruan të gjitha tiparet e një arme mbrojtëse autoktone, e cila është gjetur shpesh në territorin shqiptar e më gjerë.

8

CEKA 1967, f. 101-109.

Mburoja e përdorur në monedhën e re si simbol faqeje, është shumë e ngjashme me atë të përdorur në monedhat e prera nga qyteti i Skodrës dhe ai i Lissos, pra me tipin mburojë/përkrenare⁹. Ndryshimi i tipit të ri me tipet e prera në Skodër dhe në Lissos qendron tek simboli i shpinës. Përdorimi në shpinë të monedhës i një simboli të ri sikurse është bashi i anijes, i papërdorur më parë në këtë formë si në monedhat e Skodres ashtu edhe tek ato të Lissos, përbën një tip të ri.

Dy elementë e lidhin këtë monedhë me atelienë e Skodrës:

- Së pari, përdorimi i anijes liburne si simbol shpine, në këtë rast i përgjysmuar (në monedhat e Skodrës të tipit Zeus/anije liburne, anija është dhënë e plotë)
- Së dyti, legjenda ΣΚΟΔ-ΠΙΝΩΝ, të cilën në nëntë copët që ne posedojmë, kemi arritur ta lexojmë megjithë vështirësitë e shkaktuara nga madhësia e monedhës dhe korrozioni.

Natyrisht, në Numizmatikë njihet fenomeni i paraqitjes së një simboli të përgjysmuar. Kështu, kemi përdorimin e gjysëm lopës si simbol faqeje tek hemidrachmet e Dyrrahut dhe të Apolonisë¹⁰, që shpreh gjysmën e vlerës së drahmes apo edhe tek monedhat e Korkyrës¹¹, si dhe gjysëm pegazin në ato të Dyrrahut¹². Kjo ishte një zgjidhje praktike, mbasi nëpërmjet simbolit figurativ, i përfaqësuar nga anija (vlerë e plotë) apo bashi i anijes (gjysmë vlere), shprehej vlera e monedhës dhe krijohej njëfarë lehtësimi në marrëdhëniet monetare¹³. Në rastin tonë, monedha me mburojë/gjysmë anije, shpreh gjysmën e vlerës së monedhës të tipit mburojë/përkrenare. Vendin e përkrenares në shpine e kish zënë gjysmë anija liburne, e cila në formën e saj të plotë ishte një simbol përfaqësues i Shkodrës, sepse siç del edhe nga burimet historike, ky qytet sikurse edhe liqeni labeat, ishin vendi më i përshtatshëm për ndërtimin e anijeve. Ashtu sikurse Egina dallohej nga breshka, Korinthi nga Pegazi, Athina nga bufi, Skodra dallohej nga anija liburne.

Kronologjikisht këtë monedhë e vendosim në periudhën e parë të prerjeve të Skodrës, pra para prerjeve të Gentit për këto arsye:

1. Ngjashmëria e kësaj monedhe me monedhën me mburojë/përkrenare, të prerë nga Skodra e Lissos para sundimit të Gentit.

⁹ Shih më lart

¹⁰ GJONGEÇAJ 2015, f. 317-327.

¹¹ SNG EVELPIDIS 1975, nr. 1895.

¹² GJONGEÇAJ 2015, f. 233-237.

¹³ CEKA 2008, f. 37.

2. Legjenda e qytetit, ΣΚΟ-ΔΡΙΝΩΝ ose ΣΚΟΔ-ΡΙΝΩΝ, e ndarë në dy pjesë, është e vendosur sipër bashit të anijes, ashtu sikurse në tipet e tjera të prera nga punishtja e Shkodrës, të prera para sundimit të Gentit.
3. Përdorimi i Σ të thyer dhe jo lunare.
4. Mungesa e emrit të nëpunësit.
5. Peshë dhe diametri i vogël e lidh këtë monedhë me nënfishet e tipit mburojë/përkrenare, kështu ne i vlerësojmë këto dy emisione si gjysëm vlerë të tipit mburojë/përkrenare.

Tipi II

Fq. Koka e Artemisë me kurorë dj., brenda një rrethi.

Shp. Rrufe, ΣΚΟ-ΔΡΙΝΩΝ në dy rreshta.

AE. 1,29-1,30 gr., 11mm.

(Koleksion Privat)



Fig. 3.

Ky emision, unikal deri më sot, i përket një koleksionisti privat, Z. Gjergji Kurti të cilin e falenderoj që ma vuri në dispozicion që ta botoj. Është gjetur rastësisht në fshatin Grishe pranë Shkodrës nga i ati, i cili ka qenë mësues në këtë fshat. Mban në faqe kokën e Artemisë me kurorë, të kthyer djathtas, ndërsa në shpinë ka rrufenë. Nuk ishte e vështirë për ta identifikuar sepse lexohet qartë legjenda e qytetit ΣΚΟΔ-ΡΙΝΩΝ. Ky emision është i ngjashëm me monedhat e Lissos, të tipit Artemis/rrufe, qoftë përse i përket trajtimit stilistik të perëndisë, qoftë edhe të peshës¹⁴. Ndryshimi i vetëm gjendet tek legjenda e qytetit, ΣΚΟΔ-ΡΙΝΩΝ. Monedha ka një diametër 11 mm dhe peshë 1,29/1,30 gr., pra të njëjtë me peshë dhe diameter si monedha e Lissos, me të cilën duhet të jetë e njëkohëshme. (Artemis-Rrufe, ΛΙΣΣΙ-ΤΑΝ, 1,10-1,30 gr.), prerë para sundimit të Gentit.

Megjithëse mbajnë të njëjtat simbole faqeje dhe shpine, si dhe të njëjtën peshë, ato janë prerë në dy punishte të ndryshme, në Skodër dhe Lissos. Kanë qarkulluar bashkë deri në momentin e sundimit të Gentit, i cili më pas ua hoqi të drejtën e prerjes së monedhave autonome të dy qyteteve.

Nga monedhat e prera në punishten e Shkodrës në vitet 250- 181 p.e.s., sot kemi këtë koleksion të plotësuar me gjetjet e reja (**Fig. 4**):

Nr	Tipi	Legjenda	Pesha (gr.)	Sasia (copë)	Bibliografia
1	Zeus / Anije ilire	ΣΚΟ-ΔΠΙΝΩΝ	4 - 5		Islami 1972
2	Mburojë / përkrenare ilire	Σ-ΚΟ-ΔΠΙ-ΝΩΝ	2.10 -3.5		Islami 1972
3	Mburojë / bashi i anijes	ΣΚΟΔ-ΠΙΝΩΝ	0.86 -1.96	9	Pabotuar
4	Artemis /rrufe	ΣΚΟ-ΔΠΙΝΩΝ	1.30	1	Pabotuar

Fig. 4.

Tipi III

Fq. Koka e Zeusit me kurorë dj.

Shp. Busti i një luftëtari me kausia dj., pas koke ΣΚΟ-ΔΠΙ(ΝΩΝ)

AE. 4.50 gr, 17 mm, 6 h. Fig 5.

Është unikal, pjesë gjithashtu e një koleksioni privat, gjetur rastesisht në afërsi të Shkodrës. Në këtë monedhë është vendosur si faqe, koka e Zeusit përdorur shpesh në monedhat e para të prera nga Shkodra, para sundimit të Gentit, të cilat shoqëroheshin në shpinë me anijen liburne¹⁵.

Monedha jonë mban në shpinë bustin e një luftëtari me kausia, përdorur në faqen e monedhave të Gentit, të cilat shoqëroheshin gjithashtu me anijen liburne dhe që janë prerë në kohën e sundimit të këtij mbreti. Elementët që vëmë re në shpinë korespondojnë me disa shkronja të legjendës së qytetit. ΣΚΟ-ΔΠΙ...në dy rreshta, të vendosura pas kokës, pra një simbol i mbiprerë. Pra, në vend të tipit Zeus/ anije liburnite prerë nga Skodra, apo busti i Gentit/ anije liburnite, prerë nga mbreti Gent, ne kemi një monedhë që mban dy simbole të përzgjedhura nga dy prerjet e mësipërme, pra kokën e Zeusit nga monedha e parë (Zeus/ anije) dhe bustin e një luftëtari ilir, i ngjashëm me mbretin Gent, duke formuar kështu një tip të ri (kokë e Zeusit/busti i një luftëtari ilir). Monedha ruan të njejtën peshë me monedhat e Shkodrës të prera para sundimit të Gentit.

¹⁵

ISLAMI 1972, f. 394-395.



Fig. 5.

Sipas mendimit tonë, është një monedhë e mbiprerë mbi një monedhë tjetër, luftëtari është vendosur mbi anijen liburne, pra mbi simbolin e shpinës së monedhës së Shkodrës të tipit Zeus/anije liburne, duke lënë gjurmët e legjendës së monedhës së parë.

Fakti që ky simbol është vendosur në shpinë tregon se nuk kemi të bëjmë me një monedhë mbretërore, ku mbreti kokën apo bustin e tij e vendos në faqe pasi figura e tij, sipas të lashtëve, është po as e rëndësishme sa edhe figura e perëndive. Mendojme se duhet të jetë një falsifikim antik, i bërë ndoshta nga falsifikatorë privatë. Nuk mund të përjashtojmë edhe rastin e një falsifikimi të bërë nga punishtja e Shkodrës, pasi fabrikimi i monedhave kërkonte disa aftësi teknike, të cilat mund t'i kishin vetëm disa persona që e njihnin këtë teknikë.

Në numizmatikën ilire njihet edhe një rast tjetër kur përdoren monedhat e mëparshme për të prerë të reja, pra ristampohet faqja apo shpina e monedhës mbi simbolin e mëparshëm. Është fjala për thesarin e Apolonisë 1941, i përbërë me drahme të Dyrrahut të falsifikuara.¹⁶

Natyrisht ky fenomen ndodh në situata krizash finaciare apo edhe në raste adhurimi për figurën e përdorur në një monedhë, si simbol faqeje apo shpine.

Përfundime:

1. Ndërmjet Shkodrës e Lissos ka patur lidhje të forta ekonomike që rregulloheshin me një aleancë në fushën monetare, e mbështetur në prerjen e të njejtave tipe monedhash, që mbanin jo vetëm të njejtat simbole, por edhe të njejtën peshë e masë. Këtë ide e përforcojnë më shumë edhe gjetja e emisioneve të reja. Nga ana tjetër, secili qytet ruante një autonomi politike, e cila shprehet me vendosjen e emrit të qytetit që e priste, autonomi që zgjati deri në periudhën e sundimit të Gentit.
2. Të dy qytetet kishin marrëdhënie të forta njëherazi ekonomike dhe tregëtare me Dyrrahun, kjo shpjegohet jo vetëm me përdorimin e kokës së Zeusit

¹⁶

GJONGEÇAJ-VANGJELI 2015, f. 131-134.

në një nga monedhat kryesore të Shkodrës ashtu sikurse në monedhën prej bronzi më të zakonshme të Dyrrahut, por edhe në peshat e njejta që kanë monedhat e këtyre dy qyteteve me ato të Dyrrahut (**Fig. 6**). Vlen të përmendet se emisioni i ri, ai me mburojë/gjysmë anije, ka të njejtën peshë dhe diametër me ato me kokën e Herakliut/armët e tij të prera në Dyrrah. Janë monedha me një diametër 10 mm e peshë 1-2 gr. Kjo vazhdon pastaj edhe me prerjet e tjera të Skodrës si Zeus/anije, i barabartë me Zeus/Trikembësh të Dyrrahut.

3. Nga gërmimet e bëra në Lezhë nga ekipi shqiptaro-gjerman, monedhat e Dyrrahut zënë 62% të të gjitha monedhave të gjetura aty (nga 168 copë gjithsej).

Nr.	Tipi		Vlera	
	Monedhat e Skodrës	Monedhat e Dyrrahut	Pesha (gr.)	Diam. (mm)
1	Zeus / Anije ilire	Zeus /Trikëmbësh	4 - 5	19/21
2	Mburojë / Përkrenare ilire	Athina / rrufe	2 - 3	13/15
3	Artemis/ Rrufe	Herakli / armët e tij	1.30	11/12
4	Mburojë / Bashi i anijes	Herakli / armët e tij	1.06 - 1.95	10/12
5	Mburojë / Bashi i anijes	Herakli/armët e tij	0.50 - 0.70	8/10

Fig. 6.

4. Prerja e monedhave me vlera të vogla tregon se në shekujt III-II p.e.s. ekonomia ishte monetarizuar, shkembimi në natyrë ishte zëvendësuar me atë monetar. Në jetën e përditshme lypseshin vlera të ndryshme për të marrë mallra me vlera të ndryshme.
5. Në tipologjinë e monedhave të Skodrës dhe Lissos ndihet një orientim pro maqedonas, lidhur kjo me situatat politike, aleancat e mbretërve ilirë me Maqedoninë në luftë kundër Romës, por që do të thellohet më shumë në kohën e Gentit, kur mbreti pajiset me kausia ashtu sikurse mbretërit maqedonas.

Genti mori pushtetin në vitin 181 p.e.s. dhe kishte lidhje të forta me Perseun e Maqedonisë, i cili po përgatitej në luftë kundër Romës. Me ardhjen në pushtet, Genti ndërmoi shumë masa, midis të cilave ishte edhe vendosja e taksave. Ai realizoi edhe një reformë në sistemin monetar, e cila mbështetej në këto drejtime:

- A. Unifikimin e monedhës së prerë nga dy qytetet Shkodër e Lissos në një të vetme, duke i hequr të drejtën e autonomisë monetare këtyre dy qendrave të rëndësishme të mbreterisë;
 - B. Vendosjen e emrit dhe portretit të tij mbi monedha;
 - C. Ruajtjen e atyre simboleve të traditës së vjetër që i siguronin monedhës vazhdimësinë dhe me të cilat popullsia ishte mësuar;
 - D. Ruajtjen e të njëjtës peshë e masë si të monedhave të mëparshme. (**Fig. 7**)
- E përdori këtë monedhë për qarkullim të brendshëm në territorin e mbretërisë së tij sepse gjetja e saj në territore të largëta është e rallë (Apoloni, Foinike, Dyrrah). Mbreti vetë kishte siguruar një pasuri që mbështetej në drahmet e Dyrrahut dhe të Apolonisë, si dhe në denaret romakë që kishin vlerë më të madhe se monedhat prej bronzi, të prera në vend. Sipas të dhënave të Tit Livit, mësojmë se kur ai u zu rob në vitin 168 p.e.s., në arkën e tij u gjetën 27 ponde ari, 120000 drahme ilire dhe 13 mijë denarë romakë.

Nr	Tipi	Pesha (gr.)	Skodra	Lissos	Genti
1	Zeus ose Gent / anije ilire	4 - 6	Koka e Zeusit ΣΚΟ-ΔΡΙΝΩΝ ou ΣΚΟΔ-ΡΙΝΩΝ		Koka e Gentit ΒΑCΙΛΕΩC ΓΕΝΘΙΟΥ
2	Mburojë / Përkrenare ilire	2.80 -3.30	Σ-ΚΟ-ΔΡΙ-ΝΩΝ	ΛΙCΣΙ-ΤΑΝ	ΒΑCΙΛΕΩC ΓΕΝΘΙΟΥ
3	Artemis/ rrufe	1.10-2.15	ΣΚΟ-ΔΡΙΝΩΝ	ΛΙCΣΙ-ΤΑΝ	ΒΑCΙ-ΓΕΝ
4	Dhi/ rrufe	1.60		ΛΙCΣΙ-ΤΑΝ	
5	Mburojë/bashi i anijes	0.86 -1.96	ΣΚΟΔ-ΡΙΝΩΝ ou ΣΚΟ-ΔΡΙΝΩΝ		

Fig. 7

BIBLIOGRAFIA

BRUNSMID 1898

J. BRUNSMID, Die Inschriften und Munzen der Griechischen stated Dalmatiens“, Wien 1898, f. 70-75 in *Abhandlungen des Archaeologisch-Epigraphischen seminaries der Universitat*, Wien, Heft XIII.

CABANES 1988

P. CABANES, *Les Illyriens, de Bardylis à Genthios, IVe au IIe siècle avant J.-C.*, Paris, 1988

CEKA 1967

H. CEKA, *Probleme të Numizmatikës Ilire*, Tiranë 1967.

ECKHEL 1779

I. ECKHEL, *Doctrina Numorum Veterum*, Pars I, Volum II. Vindobonae, MDCCXCIV.

EVANS 1880

A. J. EVANS, “On some recent discoveries of Illyrian coins”, në *Numismatic Chronicle and journal of the Numismatic Society*, London 1880, f. 269-302.

GJONGECAJ 2015

SH. GJONGECAJ, « Un nouveau type en argent de Dyrrachion », *Revue Numismatique* 2015, f. 233-237.

GJONGECAJ-VANGJELI 2015

SH. GJONGECAJ-VANGJELI, *Trésors de monnaies antiques trouvées en Albanie (V-I siècle av. J.-C.)*, Tirana 2015.

ISLAMI, CEKA 1964

S. ISLAMI, H. CEKA, « Nouvelles données sur l’Antiquité illyrienne dans le territoire Albanais », *Studia Albanica* 1964/1, f. 91-137.

ISLAMI 1972

S. ISLAMI, « Le monnayage de Scodra, Lissus et Genthios », *Iliria* II (1972), f. 379-408.

PRASCHNIKER, SCHOBER 1919

C. PRASCHNIKER, A.SCHOBER, *Archeologische Forschungen in Albanien und Montenegro*, Wien 1919.

SCHOLZ 1901

J. SCHOLZ, *Beitrag zur Munzkunde von Skodra- Illyricum in Monatsblatt der numismatischen Gesellschaft*, Wien 1901, Band V.

SNG EVELPIDIS 1975

Sylloge Nummorum Graecorum, Collection Rena H.Evelpidis, Athenes, Louvain 1975.

WILKES 1992

J. WILKES, *The Illyrians*, Oxford 1992.

SUMMARY

NEW MONETARY ISSUES FROM THE ANCIENT CITY OF SHKODRA (SCODRA)

In this article are published, for the first time, new issues minted by monetary workshops of Scodra, which shed new light both on the history of this city - a very important centre of Illyrian Kingdom, and on the relations the city maintained with Lissos, Dyrrhachion and King Gentius.

According to the following study, we have come to some conclusions :

- Scodra and Lissos sustained very strong economic relations that were regulated by a monetary alliance based on minting of the same types of currencies that held not only the same symbols, but also the same weight. On the other hand, each city preserved its own political autonomy, which is expressed by the legend of each city minting the coins, an autonomy that lasted until the rule of Gentius.

- Both cities maintained strong economic and trade relations with Dyrrachion: this is explained by the use of Zeus head in one of the main coins of Scodra, a symbol quite common in bronze coins of Dyrrhachion, as well as the same weights. It is worth mentioning that the new shield/semi-ship type has the same weight and diameter as the coins bearing the head of Heraclius/arms, minted by Dyrrhachion. They present a 10 mm diameter and weight about 1-2 gr. These elements persist on other coins from Scodra, such as Zeus/ship type which is equal to the type of Zeus/Tripod from Dyrrhachion. According to the results of the archeological excavations undertaken by the Albanian-German team in the city of Lezha, the coins of Dyrrhachion dominate with 62% of all coins (out of a total of 168).

- Minting coins of small dimensions shows that during the III-II centuries BC the economy was monetarised, the exchange in nature was replaced by the monetary one. On daily life bases, different values were required to obtain goods of different value.

- The typology of the coins by Scodra and Lissos, expresses a pro-Macedonian orientation, clearly related to the political situation and the alliances of the Illyrian kings with Macedonia against Rome, but which will be further strengthened during Gentius period when the image of the king will be accompanied by the *kausia*, just like the Macedonian kings.

With his coming to power, Gentius, along with other measures, established a taxation system and carried out a reform in the monetary system.